



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/38  
Datë: 30.10.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 167 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr. 08/109 të datës 02.07.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet/plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr.12/36 i datës 19.10.2020.
2. Pika një (1) e Vendimit Nr.12/36, të datës 19.10.2020, ndryshohet/plotësohet si vijon:
  - 2.1. Aprovohen Tarifat e Përgjithshme Mujore për Shfrytëzimin e Lëndës së Mbrojtur me rastin e Ritransmetimit.
3. Pika dy (2), e Vendimit Nr. 12/36, të datës 19.10.2020, ndryshohet/plotësohet si vijon:
  - 3.1. Tarifa mujore për kompensim bazohet për grupet e kanaleve televizive të ritransmetuara sipas kategorizimit, si në vijim:
    - 3.1.1. Deri në 70 TV kanale – 0.30 euro për abonues;
    - 3.1.2. Nga 71 deri në 100 TV kanale – 0.35 euro për abonues;
    - 3.1.3. Nga 101 deri në 150 TV kanale – 0.40 euro për abonues;
    - 3.1.4. Mbi 151 TV kanale – 0.45 euro për abonues.
4. Pika tre (3) e Vendimit Nr.12/36, të datës 19.10.2020, ndryshohet plotësohet si në vijim:
  - 4.1. Obligohen të gjithë operatorët kabllorë dhe subjektet tjera që të bëjnë ritransmetimin e kanaleve televizive për zbatimin e këtij Vendimi.
  - 4.2. Zbatimi i Vendimit, përkatësisht tarifave të Përgjithshme Mujore për Shfrytëzimin e Lëndës së Mbrojtur me rastin e Ritransmetimit, fillon nga data 01.04.2021.
5. Dispozitat tjera të Vendimit Nr. 12/36 i datës 19.10.2020, mbeten të pandryshuara.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HODI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Komisionit të Pavarur të Mediave
- Arkivit të Qeverisë